



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III

Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri
Mbledhja nr. 16
Prishtinë, me 30 tetor 2008
Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

P R O C E S V E R B A L
nga mbledhja e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri

Në mbledhje morën pjesë: Shkumbin Demaliaj, Emrush Xhemajli, Naim Maloku, Gani Geci, Zafir Berisha, Eqrem Kryeziu, Melihate Termkolli dhe Zulfi Merxha.

Munguan: Bojan Stojanovič dhe Agim Veliu

Nga zyra mbështetëse mori pjesë: Nur Çeku, Antigona Ibraj

Mbledhjen e kryesoi:
Rrustem Mustafa, kryetar i Komisionit

Për këtë mbledhje është propozuar ky rend ditë:

- 1. Miratimi i rendit të ditës**
- 2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e datës 15.10.2008**
- 3. Shqyrtimi i raportit për Ligjin për Tubimet Publike**
- 4. Prezantim nga Komandanti i TMK-së para komisionit**
- 5. Të ndryshme**

- 1. Miratimi i rendit të ditës**

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e mbledhjes. Ai propozoi një ndryshim në rendin e ditës, që për shkak të pjesëmarrjes së Komandantit të TMK-së Gjeneral Sylejman Selimi pika e katërt e rendit të ditës të shqyrtohet në fillim, e pastaj të vazhdohet sipas agjendës së parapare dhe ky propozim u miratua me komisioni.

4. Prezantim nga Komandanti i TMK-së para komisionit

Në fillim kryesuesi tha se sot kemi mbledhjen e radhës por kemi dashur të njoftohemi nga Komandanti i TMK-së për rrjedhën e proceseve ne TMK. Në fillim z. Komandant ju e keni fjalën e pastaj deputete –anëtar të komisionit kanë mundësi të bëjnë pyetje në çështjet që u interesojnë.

Gjeneral Sylejman Selimi-Faleminderit shumë për mundësinë që të shpreh para jush rrjedhën e procesit të shpërbërjes se TMK-së. Kanë filluar të shfaqen pakënaqësi. Vet struktura e TMK-së është strukture e ndryshme prej asaj të FSK-së. FSK-ja do të jetë force operationale. Tani jemi në fazën e testimi dhe kontrolleve mjekësore për pjesëtarët që do të kyçen në FSK.

TMK-ja do të përmbyllë misionin me 10 dhjetor ndërsa ligjërisht ai mision parashihet të mbyllet me 10 qershor të vitit të ardhshëm. Në këtë rrugëtim kemi disa vështirësi. Shumë pjesëtar të TMK-së mund të mos të përfshihen në FSK. Ligji për pensionim të TMK-së është miratuar por ka pakënaqësi edhe për ligjin por në i kuptojmë kufizimet buxhetore por ligji mund ti shtohet ndonjë aneks i cili do të mundësonte që pjesëtarët e TMK-së të lroheshin nga pagesa e shërbimeve mjekësore etj.

Unë kam disa ide rreth sistemimit të pjesëtareve të cilët mbesin jashtë Forcës së Sigurisë si p.sh. rekrutimi në policinë kufitare që dëshiroj ta elaboroj këtu. Në mendojmë se një numër i pjesëtareve të TMK-së ka mundësi të përfshihen në këtë njësi. Unë kam biseduar me stafin komandues të policës së Kosovës. Kjo njësi parashihet të këtë rreth 900 pjesëtar dhe unë mendoj se kjo ide është lehtë e realizueshme. Bashkë me Qeverinë ka mundësi të këta pjesëtarë të sistemohen edhe ne ministri të ndryshme. Por tash për tash nuk jemi në gjendje të themi se këto ide janë definitive. Gjithashtu jemi në fazën e dorëzimit të objekteve të TMK-së të cilat tash do të menaxhohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Institucionet e Kosovës duhet të reflektojnë me shumë për këtë proces që mos të këtë pakënaqësi.

Kryesuesi i mbledhjes- tha se ne komision kemi diskutuar për këtë proces. Jemi në mbështetje të Juve. Ka shumë mekanizma ku pjesëtarët e TMK-së mund të kyçen. Në si komision jemi të gjithë një zëri në mbështetje tuajin.

Shkumbin Demaliaj- Ju dërgoj mesazh urime se pari. Besoj se puna do të shkojë mbare. Ka mundësi të alternative ligjore që me akte nënligjore të kryhet ky mision dhe s'do këtë asnjë alarmim besojmë.

Eqrem Kryeziu – Përsëritës Komandantin dhe stafin e tij. Nuk është situatë e lehtë ky proces. Dilemat që ju i thate se kemi janë të arsyeshme dhe në si komision do tu përkrahim.

Melihate Termkollit- Tema që shtrohet këtu është shumë konkrete. Nuk do duhej që të bisedohet se diçka po prehet. Veç ligjit që është miratuar Qeveria ka për obligim të kujdeset të përgatisë një plan shtesë për trajtimin e kësaj pjese të mbetet jashtë procesit.

Unë mendoj se kemi edhe shumë mundësi për veç këtyre që u diskutuan këtu. Unë pajtohen me këto propozime që u shtruan këtu. Ky është interes i përgjithshëm.

Haxhi Merxha- Z. Gjeneral në si komision edhe ne mandatin e kaluar edhe ne këtë mandat asnjëherë kurrë s'ju kemi harruar si TMK. Transformimi i UÇK që na pruri lirinë kur u transformuar ne TMK-në ne nuk ishim atëherë. Tash po duhet të transformohet të behet një ushtri e re. Unë beso se ky komision përherë ka me qene me ju dhe do tu përkrah.

Naim Maloku- Gatishmëria juaj për tu përgjigjur ftesës për debat ne Komision dëshmon se ne po ndërtojmë Institucione që i respektojnë dhe u nënshtrohen ligjeve. Sa i parkete ligjit për pensionim se ju keni qene vet pjese e grupit kur ligji është hartuar. Ligji është shumë i avancuar. Kurse sa i përbëtë ligjit për Shpërbërjen e TMK-së, Qeveria e Kosovës ka detyrë të formojë grupin ndërministror për këtë proces. Kryetari i Komisionit do të intensifikojë kontaktet me Qeverinë sepse ky ligj e parasheh se komisioni për siguri do të mbikëqyrjes procesin e shpërbërjes se TMK-së.

Ka shumë institucione që do të ngritën e që ligjet për to janë miratuar. Është ministria për FSKS-në, Agjencia e inteligjencës, Policia Kufitare, etj. dhe në kushte të barabarta të konkurrimit për këto vende pjesëtarët e TMK-së të kenë përparësi.

Në fund kërkojmë nga ju që në momentin e dorëzimit të objekteve tuja ato duhen të jenë shembull për nivelin e trajtimit dhe ato janë pasuri e vendit.

Gani Geci – Nëse ju referohem shifrave atëherë shohim se jo të gjithë pjesëtarët e sotëm të TMK-së do të mund të kalojnë të Forcës e re. Por pjesëtarët e TMK-së duhet të trajtohen me ligj. Ata kanë dhënë kontribut në çlirimin e vendit ata meritojnë trajtimin e duhur dhe të kenë përparësi të punësohen ne vendet tjera. Tani Kosova do të ndërtojë forcën e vet profesioniste të standardëve të NATO-s. Ngritja dhe profesionalizmi i kësaj force është ime i rëndësishëm se sa për të qene pjesëtar i saj. Komisioni do të mbështet përherë në angazhimin tuaj.

Zafir Berisha- Ju kuptoj se gjendeni ne momentin të vështire. Ne vitin 1999 kur u transformua UÇK- nuk kemi pasur institucione si sot për mbështetje. Unë dua të ngris një çështje këtu që është ruajtja e arkivave që sot gjenden në zonat dhe objektet e TMK-së. Ato arkiva duhet të ruhen.

Kryesuesi – Nga diskutimet e anëtareve të komisionit ishin komente dhe përkrahje për punën e TMK-së dhe Ju z. Komandant.

Gjeneral Sylejman Selimi- Faleminderit shumë për përkrahjen e dhënë .Sa i përketë çështjeve që u përmenden këtu mend të them se procesi i nderimit të FSK-së është proces që është duke u bere nga NATO-ja në bashkëpunim me ne. Tjetër ruajtja e arkivave dhe muzeve është shqetësim i yni për ne jemi duke biseduar edhe me shoqatat e dala nga lufta e UÇK-së për ruajtjen e arkivave. Objektet që ka pasur deri me sot në përdorimin TMK-ja do të dorëzohen në gjendjen me të mirë të mundshme. Krejt në fund ju falënderoj për angazhimin dhe përkrahen tuaj dhe jam i gatshëm përherë ti përgjigjem ftesës se komisionit .

Pas përfundimit të kësaj pike u vazhdua me pikën e dytë

2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së datës 06.10. 2008

Procesverbali i mbledhjes së datës 06.10.2008, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Ligjit për Tubimet Publike

Kryesuesi- theksoi se me sipas vendimit të Kuvendit të Kosovës datë 18 korrik 2008 komisioni ynë është ngarkuar të për ta shqyrtuar këtë ligj i cili është ligj është një prej 18 ligjeve të pa nënshkruara nga PSSP-ja që tani janë kthye në Kuvend për rishqyrtim. Agim Veliu ka qene referues. Ai sot nuk është në prezent për shkak së ka udhëtuar në Zvicër. Si referues ai ka sjellur raportin me propozime. Por pastaj edhe Ministria e Punëve të Brendshme ka sjellur disa propozime shtese. Ndërsa dje kanë ardhur propozime nga EULEX-i dhe ICO-ja. Prandaj unë propozoj që shqyrtimi i ligjit të shtyhet për mbledhjen e ardhshme në mënyrë që bëhet harmonizimi i të gjitha propozimeve. Mund të ndodhë që ky ligj edhe ti kthehet Qeverisë për ri-draftim.

Si konstatim i kësaj pike u vendos që grupi referues edhe njëherë të shqyrtojë të gjitha propozimet për të parë mundësinë e procedimit për miratim në Kuvend të këtij ligji apo ti kthehet Qeverisë për ri-draftim.

4. Të ndryshme

Në kuadër të kësaj pike tjetër u diskutua propozimi i OSBE-së, që në bashkëpunim me OJQ- KIPRED, që përfshinë disa vizita të komisionit në teren, me popullatë të përzier dhe unë propozoj që të merremi vesh se si e shohim këtë projekt. Anëtarët e komisionit u pajtuan me këtë propozim. Ky projekt u elaborua nga përfaqësuesi i OSBE-z. Armend Bekaj i cili theksoi se ky projekt ka si qëllim njohjen dhe takimin e komisionit me komunitete të ndryshme në vend dhe perceptimet e qytetareve për nivelin e sigurisë ndërsa partneri ynë KIPRED-i pastaj do të hartojë një raport në fund të projektit.

Si konstatim i kësaj pike u vendos që të caktohen disa lokacione brenda Kosovës që këto vizita të realizohen dhe të filloj nga mesi i muajit nëntor.

Mbledhja përfundoi në orën 13.00

Rrustem Mustafa
Kryetar i Komisionit

Përgatiti:
Njësia mbështetëse e komisionit

